

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " Gran Gelato " SH.P.K.

Sot, me datë 03.03.2025

- **Z. Lorenzo Bushi**, shtetas Shqiptar, lindur më 30.09.1994 në Polican, Shqiperi, mbajtës I Kartes se ID me nr 039690304 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z Massimiliano Zanoni** atësia Giuseppe, shtetas Italian, lindur në Itali dhe banues në Itali, me adresë Via miglioranza 14, Udine, Itali madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftimi ID nr. personal CA45002UD.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Gran Gelato**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Gran Gelato**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga: Plazh/13, Shkalla: -1, ndodhur ne ZK 8518, nr. Pasurie 38 fq.80, Durrës. Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *Akulllore dhe Bar-Kafe. Import i lendes se pare per akulllore.*

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 300,000 Lek (treqind mijë leke) dhe përbëhet nga 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Lorenzo Bushi** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 150,000 Lek dhe 150,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Z. Massimiliano Zanoni** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 150,000 Lek dhe 150,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Lorenzo Bushi** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Lorenzo Bushi**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 039690304, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Lorenzo Bushi



Z. Massimiliano Zanoni

